

QYTETARIA AKTIVE



PERCEPTIME NGA TË RINJTË NË QARKUN ELBASAN

Tiranë, 2022

Ky botim u përgatit përmes projektit "RINIA: KREATIVET – AKTIVIZËM" të mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

"Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Publikimet e Rrjetit të Profesionistëve të Rinj nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim. "

Autorët: Alkida Lushaj, Françeska Muço

TABELA E PËRMBAJTJES

	Lista e Figurave	3
	Lista e Tabelave	4
	Hyrja	5
I.	Metodologjia	6
II.	Koncepte Teorike mbi Qytëtarinë Aktive.....	8
III.	Analiza Statistikore e Gjetjeve.....	9
	Gjetjet Kryesore.....	22
	Rekomandime	23
IV.	Bibliografia	24
V.	Aneksi.....	25

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Gjinia e të rinjve të intervistuar.....	9
Figura 2. Niveli arsimor i të rinjve.....	10
Figura 3. Statusi i të rinjve.....	10
Figura 4. Bashkia ku jetojnë të rinjtë e intervistuar.....	11
Figura 5. % e të rinjve të angazhuar në shoqatë/organizatë joqeveritare/klub ose forum rinor.....	11
Figura 6. Anëtarësimi i të rinjve në shoqatë/organizatë joqeveritare/forum.....	12
Figura 7. % e të rinjve që kanë kryer punë vullnetare.....	12
Figura 8. % e ndikimit të punës vullnetare.....	13
Figura 9. Niveli i dëshirës për tu angazhuar në punë vullnetare.....	13
Figura 10. % e angazhimit me punë vullnetare.....	14
Figura 11. % aktivitetit që të rinjtë kanë marrë pjesë.....	14
Figura 12. % e ndikimit të aktivizimit në komunitet tek të rinjtë.....	15
Figura 13. % e të rinjve që diskutojnë aktivizimin në komunitet.....	15
Figura 14. % e të rinjve që kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga bashkia.....	16
Figura 15. % e informimit e të rinjve mbi aktivitetet e bashkisë.....	16
Figura 16. % e informacionit për qytetarinë aktive.....	20
Figura 17. Burimi i informacionit për qytetarinë aktive.....	20
Figura 18. Arsyet e mungesës së angazhimit tek të rinjtë në komunitet.....	21

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Mosha e të rinjve.....	9
Tabela 2. Karakteristikat e qytetarit aktiv sipas të rinjve.....	17
Tabela 3. Takimet ku duhet të marrë pjesë një qytetar aktiv.....	18
Tabela 4. Ndërhyrjet që bashkia/vendimmarrësit duhet të ndërmarrin.....	18
Tabela 5. % e aktiviteteve ku të rinjtë dëshirojnë të marrin pjesë.....	19
Tabela 6. Efektet e qytetarisë aktive sipas të rinjve.....	19

I. HYRJA

Një shoqëri demokratike është e bazuar fillimisht në një shoqëri të përbërë nga qytetarë që dinë të veprojnë për ndryshim, dinë të jenë aktiv për komunitetin ku jetojnë nëpërmjet një sërë metodash për të qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse ose/dhe me anë të reagimit të tyre. E gjithë kjo veprimtari dhe kulturë për të vepruar përkthehet në atë që shpesh quhet qytetari aktive. Qytetaria aktive, së cilës do t'i jepet shpjegimi edhe më poshtë dhe është fjala kyçe e këtij dokumenti është e rëndësishme për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe politik të një shoqërie dhe sidomos në vende me demokraci hibride, siç është edhe Shqipëria.

Në shoqërinë shqiptare përpos veprimtarive që ndërmerren lidhur me qytetarinë aktive dhe të gjithë kuptimet e saj në të gjithë dimensionet e shoqërisë nevojiten ndërhyrje që masin dhe zhvillojnë kapacitetet që kanë të rinjtë për tu vepruar në formë aktive në shoqëri dhe për të advokuar problematikat me të cilat ata përballen.

Në kuadër të shumë nismave të dedikuara për qytetarinë aktive dhe të rinjtë, u zhvillua ky raport që synon të masë perceptimet e të rinjve, konkretisht përqëndruar në qarkun Elbasan mbi qytetarinë aktive, pjesëmarrjen e tyre në iniciativa për komunitetin, vullnetarizmin, angazhimin në OJF-të, advokimi pranë autoriteteve publike, votimin, pjesëmarrjen në procese politikëbërëse dhe vendimmarrëse etj.

Njohja e perceptimeve të të rinjve për të gjitha këto procese e veprimtari të vogla në dukje por shumë të rëndësishme dhe jetike në demokraci është një nga mjetet dhe shanset që i jepet punonjësve rinorë, shoqërisë civile, autoriteteve publike lokale dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë. Kjo me synimin për tu orientuar më shumë në ndërhyrjet e ardhshme që duhen ndërmarrë për angazhimin për demokraci të të rinjve, rritjen e kulturës së ndëshkueshmërisë, edukimin mbi qytetarinë aktive dhe të gjithë formave të saj nga institucionine arsimore, institucione të nivelit lokal dhe entitete të tjera, në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin e një brezi qytetarësh aktiv dhe rritjes së ndërhyrjes me shërbime mbështetëse ndaj të rinjve.

II. METODOLOGJIA

Ky raport u zhvillua në Qarkun Elbasan me qëllim për të kuptuar perceptimet që kanë të rinjtë mbi qytetarinë aktive në nivel lokal dhe për të matur angazhimin e tyre në çështjet e komunitetit ku ata jetojnë. Kjo ndërhyrje i shërben fuqizimit të të rinjve në shtatë bashkitë e Qarkut të Elbasanit për të promovuar qytetarinë aktive dhe për të rritur transparencën në këto bashki duke forcuar gjithëpërfshirjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes.

Për marrjen e informacionit të kërkuar nga të rinjtë e qarkut Elbasan, u zhvillua një kërkim në tryezë si dhe një pyetësor specifik online me 23 pyetje të mbyllura. Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve sasiorë u hodhën e më pas u përpunuan përmes programit SPSS. Variablat ishin nominale kryesisht, kështu që u analizuan përqindjet dhe frekuenca. Komentet e vëzhguesve u hodhën dhe u përpunuan në excel.

Kampionimi i këtij raporti përfshiu 371 të rinj¹, të përzgjedhur në mënyrë rastësore nga shtatë bashkitë e Qarkut të Elbasanit si Bashkia Elbasan, Bashkia Belsh, Bashkia Cërrik, Bashkia Gramsh, Bashkia Librazhd, Bashkia Prrenjas dhe Bashkia Peqin. Shpërndarja e pyetësorit është mjaftueshëm e gjerë që të mundësojë rezultate të rëndësishme statistikore në nivel besueshmërie. Përpara aplikimit dhe shpërndarjes së pyetësorit, u zhvillua një fazë pilotimi me disa të rinj për të testuar shkallën e kuptueshmërisë dhe rrjedhshmërinë e plotësimit të pyetësorit.

Mbledhja e të dhënave u zhvillua gjatë periudhës janar - mars 2021 dhe u mundësua përmes një platforme të dedikuar online, pyetësori u diseminua në të gjitha bashkitë e Qarkut të Elbasanit nga koordinatorët e Rrjetit të Profesionistëve të Rinj.

Shpërndarja e pyetësorit u bë përmes emailit dhe rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, Twitter dhe LinkedIn, duke shfrytëzuar databazën që Rrjeti i Profesionistëve të Rinj ka.

Gjetjet e raportit u mblodhën dhe u analizuan për tu përcjellë tek politikbërësit e këtij qarku me qëllim që edhe grupe të tjera interesi apo organizata të kenë mundësinë t'i përdorin këto të dhëna për raporte, projekte apo aplikime të ndryshme.

1 Sipas Ligjit "Për Rininë" të rinj në këtë raport i referohen grupmoshës 15-29 vjeç <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>

Konsiderata etike

Të rinjve iu bë e qartë se pjesëmarrja e tyre nuk ishte e detyrueshme dhe ishte e drejta e tyre për të mos marrë pjesë apo për t'u tërhequr nga raporti në çdo kohë, apo edhe e drejta për të mos iu përgjigjur disa pyetjeve që mund të ishin të ndjeshme për ta.

Ekspertët e këtij raporti u treguan mjaft të kujdesshëm në respektimin e konsideratave etike, si:

- Anonimati – ky pyetësor u zhvillua duke respektuar të drejtën e të rinjve për të ruajtur anonimatën e tyre.
- Fshehtësia dhe mirëbesimi i plotë – të dhënat e marra për qëllimin e këtij raporti u trajtuan në formë të fshehtë dhe në mirëbesim të plotë vetëm nga ekspertët e këtij raporti dhe nuk u përdorën për qëllime të tjera, përveç atij të shpallur.

Kufizimet e raportit

Pyetësori u shpërnda tek të rinjtë në formë elektronike. Si pasojë shumë të rinjë të cilët nuk janë pjesë e rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, LinkedIn dhe nuk kanë një adresë emaili, nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë e të shprehin opinionet e tyre. Nga ana tjetër, për shkak të kushteve të krijuara nga pandemia Covid-19 dhe masave shëndetësore të shpallura nuk u krijua mundësia për të dalë në terren për të plotësuar pyetësorin ndaj u shfrytëzuan vetëm kanalet online të komunikimit.

III. KONCEPTE TEORIKE MBI QYTETARINË AKTIVE

Qytetaria Aktive ka të bëjë me përfshirjen e individëve në jetën publike dhe çështjet që mund të zhvillohen në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Qytetarë aktivë janë ata që zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit, në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin vendime të informuara në lidhje me çështje të ndryshme brenda komunitetit të tyre dhe përmirësojnë cilësinë e jetës aty.

Vullnetarizëm ose puna vullnetare në përgjithësi konsiderohet një aktivitet altruist kur një individ apo grup ofron shërbime jo për përfitime financiare apo sociale "për një tjetër person, grup ose organizatë".

Taksa janë kontribute të detyrueshme që merren nga individë ose korporata nga një njësi qeveritare - qofshin ato lokale, rajonale apo kombëtare. Të ardhurat nga taksat financojnë aktivitetet e qeverisë, duke përfshirë punë dhe shërbime të tilla publike si rrugë dhe shkolla, ose programe si Sigurimet Shoqërore dhe Mjekësore.

Organizatë nënkupton një grup njerëzish që punojnë së bashku, si një shoqatë lagjeje, një organizatë bamirësie, një sindikatë ose një korporatë.

Kreativiteti përcaktohet si prirja për të gjeneruar ose njohur ide, alternativa ose mundësi që mund të jenë të dobishme në zgjidhjen e problemeve, komunikimin me të tjerët dhe argëtimin e vetes dhe të tjerëve.

Fushatë konsiderohet një grup i planifikuar i aktiviteteve veçanërisht politike, ekonomike ose ushtarake që synojnë të arrijnë një qëllim të veçantë.

Peticion vlerësohet si një kërkesë për të bërë diçka, më së shpeshti drejtuar një zyrtari qeveritar ose një njësie publike. Një peticion është një dokument i drejtuar disa zyrtarëve dhe i nënshkruar nga individë të shumtë. Një peticion mund të jetë me gojë ose me shkrim, ose mund të transmetohet përmes internetit.

Minoriteti konsiderohet një grup i veçantë kulturor, etnik ose racor që bashkëjetonë bashkë dhe që i nënshtrohen një grupi më dominues. Në shkencat shoqërore ky term përdoret si vartësi që është karakteristikë kryesore përcaktuese e një grupi pakicash. Si i tillë, statusi i pakicës nuk lidhet domosdoshmërisht me popullsinë. Në disa raste një ose më shumë të ashtuquajturat grupe të pakicave mund të kenë një popullësi.

IV. Analiza Statistikore e Gjetjeve

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të perceptimeve që kanë të rinjtë mbi qytetarinë aktive në nivel lokal u ndërmor dhe u zhvillua ky raport, ku numri i përgjithshëm i të intervistuarve në qarkun e Elbasanit është 371 persona, nga ku janë përgjigjur 264 femra dhe 107 meshkuj.




Figura 1. Gjinia e të rinjve të intervistuar

Intervista është zhvilluar me të rinjtë e grup-moshës ndërmjet 15 deri 29 vjeç dhe vihet re se pjesëmarrja më e lartë e të rinjve në intervistë është e moshës 21 vjeç me 17.3%, pasuar me moshën 17 vjeç përkthyer në 15.2% dhe moshën 20 vjeç duke përbërë 15.0%.

Mosha	Numri i të rinjve	Përqindja
15	27	6.9%
16	56	14.2%
17	60	15.2%
18	51	12.9%
19	17	4.3%
20	59	15.0%
21	68	17.3%
22	7	1.8%
23	1	0.3%
24	3	0.8%
25	7	1.8%
26	5	1.3%
27	4	1.0%
28	2	0.5%
29	4	1.0%
Totali	371	100%

Tabela 1. Mosha e të rinjve

Sipas nivelit arsimor, shohim që 51.5% e të rinjve të intervistuar janë me arsim të mesëm, ndjekur nga arsimi universitar (BA) me 31.5%. Ndërsa sipas statusit të tyre, 46.7% janë gjimnazistë, 36.5% e tyre janë studentë dhe 9.4% janë të punësuar (figura 3).




Figura 2. Niveli arsimor i të rinjve




Figura 3. Statusi i të rinjve

Nga figura 4 shohim se të rinjtë e intervistuar për këtë raport vijnë nga qytete të ndryshme të qarkut të Elbasanit, nga ku shumica e tyre jetojnë në Elbasan rreth 36% dhe 25.4% e tyre në Belsh, pasuar me Peqin 11.9%, Librazhd 10.9%, Gramsh 5.8%, Cerrik 5.7% dhe Prenjas 4.3%.




Figura 4. Bashkia ku jetojnë të rinjtë e intervistuar

Lidhur me të dhënat specifike të nxjerra nga të intervistuarit në kontekstin e tematikës mbi aktivizimin qytetar të të rinjve në qarkun Elbasan, vërehet se 65% e tyre janë pjesë e ndonjë shoqate/organizatë joqeveritare/klub ose forum rinor, ndërsa 30.2% e tyre shprehen se nuk janë pjesë e ndonjë shoqate/organizatë joqeveritare/klubi ose forumi rinor (figura 5).




Figura 5. % e të rinjve të angazhuar në shoqatë/organizatë joqeveritare/klub ose forum rinor

Referuar të dhënave të nxjerra nga intervistimi, vërehet se 55.1 % e tyre nuk preferojnë të tregojnë llojin e organizatës apo shoqatës ku ata ndërveprojnë. Nisur nga shifra e lartë e të rinjve që hezitojnë të shprehin institucionin e tyre ku janë të agazhuar, kërkon vëmëndjen e shumë aktorëve dhe institucioneve arsimore e sociale për të kuptuar më qartë faktorët që ndikojnë tek ata/ato për të mos u shprehur.

Nga ana tjetër, në figurën 6 shohim që pjesa tjetër e të rinjve shprehen se janë të angazhuar më shumë në organizata apo shoqata me aktivitet sportiv (13.2%), vullnetar (10.4%), kulturor (7.4%), edukativ (6.1%), politik (3.8%) dhe fetar (1.5%).




Figura 6. Anëtarësimi i të rinjve në shoqatë/organizatë joqeveritare/forum

Gjatë intervistimit, vlen për tu vlerësuar fakti se shumica e të rinjve (71.8%) shprehen se kanë kryer punë vullnetare në komunitetin ku ata/ato jetojnë, ndërsa 19.8% e tyre nuk kryer ndonjë punë vullnetare në komunitetin ku jetojnë dhe 8.4% nuk janë përgjigjur.




Figura 7. % e të rinjve që kanë kryer punë vullnetare

Lidhur me perceptimin, rëndësinë dhe ndikimin që puna vullnetare ka në shoqëri dhe problematika të ndryshme, 49% e të rinjve në qarkun e Elbasanit shprehen se puna vullnetare e tyre **ka ndikuar pozitivisht** dhe 11.4% e tyre mendojnë që puna vullnetare e tyre ka patur **ndikim të madh**.

Në anën tjetër, 20.3% e të rinjëve mendojnë që ka puna vullnetare e tyre ka **ndikuar pak** dhe 19.3% e tyre mendojnë që puna vullnetare e tyre nuk ka **ndikuar aspak**.




Figura 8. % e ndikimit të punës vullnetare

Si vazhdimësi e punës vullnetare, shohim se 42.4% e të rinjve në Elbasan dëshirojnë **shumë** të angazhohen përsëri në punë vullnetare, 10.9% dëshirojnë të angazhohen **pak** në punë vullnetare dhe 10.4% nuk dëshirojnë **aspak** të angazhohen përsëri në punë vullnetare.




Figura 9. Niveli i dëshirës për tu angazhuar në punë vullnetare

Një element i rëndësishëm për tu vlerësuar është fakti që shumica e të rinjve duke përbërë 75.6% shprehen se arsyeja e angazhimit në punë vullnetare është **për të mirën e komunitetit**. Ndërsa 13.5% e të rinjve të tjerë nuk kanë dhënë përgjigje apo nuk kanë specifikuar arsyet pse ata kanë kryer punë vullnetare. Ndërkohë 7.4% shprehen se arsyeja e angazhimit në komunitet është **për arsye personale**, 2.8% e të rinjve të intervistuar kanë **arsye të tjera** dhe 0.7% angazhohen për **arsye politike**.




Figura 10. % e angazhimit me punë vullnetare

Ndërkaq lidhur me aktivitetet që të rinjtë në qarkun Elbasan kanë marrë pjesë me shpesh, shifrat tregojnë se për:

- 25.4% e të rinjve, **aktivizimi vullnetar në ndihmë për njerëzit në nevojë** është aktiviteti që kanë marrë pjesë më shpesh;
- 20.1% të tyre, **aktivizim vullnetar për pastrimin e lagjes/qytetit/komunitetit** është aktiviteti që kanë marrë pjesë më shpesh;
- 14% të tyre aktiviteti që kanë marrë pjesë më shpesh është **event kulturor, sportiv, fetar**;
- 9.1% të tyre aktiviteti që kanë marrë pjesë më shpesh është **aktivitet akademik/edukativ**;
- 5.3% të tyre aktiviteti që kanë marrë pjesë më shpesh është **protesta**;
- 3.8% të tyre aktiviteti që kanë marrë pjesë më shpesh është **aktivitete të tjera**;
- 2.8% të tyre aktiviteti që kanë marrë pjesë më shpesh është **fushatë elektorale**;
- 1.5% të tyre aktiviteti që kanë marrë pjesë më shpesh është **takim publik me vendimmarrësit e komunitetit**;
- 18% të tyre nuk janë përgjigjur.




Figura 11. % aktivitetit që të rinjtë kanë marrë pjesë

Shumica e të rinjve të intervistuar, 75.6% e tyre mendojnë që aktivizimi i të rinjve e **ndihmon** komunitetin dhe mirë funksionimin e politikave, ndërsa 15% e tyre **nuk e dinë** nëse aktivizimi i tyre mund të ketë impakt.

Krahasuar me 4.8% e tyre mendojnë që aktivizimi i të rinjve **nuk ndihmon** komunitetin dhe 4.6% e tyre **nuk janë përgjigjur**.




Figura 12. % e ndikimit të aktivizimit në komunitet tek të rinjtë

Referuar të dhënave të nxjerra nga intervistat, vihet re se shumica e të rinjve **diskutojnë** me familjarët, miqtë dhe të afërmit e tyre lidhur me çështjet e aktivizimit në komunitet, duke përbërë 69.3% të të rinjve. Ndërsa 16% e tyre **nuk diskutojnë** me familjarët, miqtë apo të afërmit lidhur me aktivizimin në komunitet.




Figura 13. % e të rinjve që diskutojnë aktivizimin në komunitet

Një e dhënë e rëndësishme vihet re se 47.2% e të rinjve shprehen se **nuk kanë marrë pjesë ndonjëherë** në takimet publike të organizuara nga bashkia ku jetojnë, ndërsa 42.4% shohim që **kanë marrë ndonjëherë pjesë** në keto takime (figura 14).




Figura 14. % e të rinjve që kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga bashkia

Gjatë analizimit të të dhënave të nxjerra nga intervistat me të rinjtë e qarkut Elbasan, shohim se 51.5% e tyre nuk janë **aspak të informuar** mbi aktivitetet që bashkia ku jetojnë organizon apo planifikon dhe 48.5% janë **të informuar** mbi aktivitetet e bashkisë ku jetojnë.

Bazuar mbi këto të dhëna, vlen të theksohet nevoja që nivelet bashkiake duhet të ndajnë informacion më shumë lidhur me aktivitetet e planifikuara për të rinjtë, drejtuar komunitetit e sidomos të rinjve dhe organizatave të ndryshme që trajtojnë çështje të mirëqenies së shoqërisë në mënyrë që të thellohet bashkëpunimi mes palëve.




Figura 15. % e informimit të të rinjve mbi aktivitetet e bashkisë

Ndërkaq, opinionet e të rinjve për karakteristikat dhe cilësitë e qytetarit aktiv vijnë si më poshtë në tabelën 2.

	Po	Jo	Nuk e di	Pa përgjigje
Paguan taksat	70.3%	14.5%	11.0%	4.2%
Voton rregullisht	59.9%	22.1%	15.5%	2.5%
Angazhohet në fushata ose peticione	53.6%	26.2%	16.7%	3.5%
Angazhohet në punë vullnetare	84.4%	8.5%	5.8%	1.3%
Beson në të drejta të barabarta për të gjithë	87.8%	8.9%	2.8%	0.5%
Kontakton përfaqësuesit e vet politikë	47.1%	29.4%	21.3%	2.2%
Mban pastër hapësirat publike	93.9%	3.3%	2.3%	0.5%
Mbron mjedisin	93.9%	2.8%	2.3%	1.0%
Merr pjesë në konsultime për çështje të ndryshme me vendimmarrësit	68.5%	14.8%	15.3%	1.4%
Merr pjesë në ngjarje publike për çështje të rëndësishme publike	75.4%	14.3%	8.8%	1.5%
Merr pjesë në zgjedhje/votime	57.8%	22.2%	18.0%	2.0%
Ndihmon fqinjët dhe komunitetin	89.2%	5.3%	4.3%	1.2%
Ndihmon këdo që ka nevojë	80.2%	9.3%	7.8%	2.7%
Ndjek zhvillimet politike të vendit	52.7%	24.1%	20.1%	3.1%
Nuk ka frikë të shprehë publikisht pikëpamjet e veta për të mirën e përgjithshme	87.4%	6.3%	5.6%	0.7%
Respekton minoritetet në komunitet	84.1%	7.3%	6.5%	2.1%

Tabela 2. Karakteristikat e qytetarit aktiv sipas të rinjve

Vihet re se shumica e të rinjve shprehen që sjelljet si kujdesi për mjedisin, marrja pjesë në votime, ofrimi i ndihmës për grupet vunerabël, marrja pjesë në evente me përmbajtje të çështjeve publike që prek mirëqenien e komunitetit janë **cilësi dhe karakteristika të një qytetari aktiv**.

Gjithashtu, shumica e të rinjve janë të mendimit se për një qytetar është **shumë e rëndësishme** të marrë pjesë në takimeve dhe eventeve publike që trajtohen çështje për komunitetin, në aktivitete vullnetare, në protestë, në takime/konsultime vendimmarrëse për të rinjtë dhe në votime.

	Shumë e rëndësishme	Disi e rëndësishme	Pak e rëndësishme	Aspak e rëndësishme
Të jetë pjesë e takimeve dhe eventeve publike për komunitetin	67.6%	25.6%	4.0%	2.8%
Të marrë pjesë në aktivitete vullnetare	75.4%	19.2%	4.7%	0.7%
Të marrë pjesë në protestë	47.3%	43.5%	4.8%	4.4%
Të marrë pjesë në takime/konsultime vendimmarrëse për të rinjtë	73.2%	20.5%	4.8%	1.5%
Të ndjek zhvillimet politike të vendit	56.3%	33.8%	4.4%	5.5%
Të votojë	60.2%	33.8%	4.5%	1.5%

Tabela 3. Takimet ku duhet të marrë pjesë një qytetar aktiv

Ndërsa nga ana tjetër, të rinjtë shprehen se bashkia apo aktorët e tjerë vendimmarrës duhet të ndërmarrin disa ndërhyrje në mënyrë që të ketë më shumë bashkëpunim ndërmjet tyre dhe të rinjve. Sipas tyre, bashkia duhet të ftoj të rinjtë në takime apo konsultime me çështje publike dhe tu japë më shumë hapësira të rinjve për të marrë pjesë në vendimarrje e për të shprehur idetë dhe nevojat e tyre. Gjithashtu të rinjtë shprehen se bashkia duhet të inkurajojë qytetarët dhe sidomos të rinjtë të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme lidhur me zhvillimin e komuniteteve.

	Shumë Dakord	Dakord	Pjesërisht Dakord	Nuk jam dakord	Aspak Dakord
Të dëgjojë mendimin, idetë dhe nevojat e të rinjve përpara marrjes së vendimit	80.6%	15.3%	3.7%	0.2%	0.2%
Të ftoj të rinjtë në konsultime publike mbi projekte dhe investime të bashkisë	73.1%	19.0%	6.9%	0.8%	0.2%
Të inkurajojë/angazhojë qytetarët dhe të rinjtë të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme	75.4%	20.6%	3.8%	0.0%	0.2%
Të jetë më transparente në vendimet që merr për të rinjtë dhe komunitetin	78.1%	18.8%	2.5%	0.3%	0.3%
Të mbështes zhvillimin e këshillave rinor	80.3%	15.5%	4.0%	0.0%	0.2%
Tu japë më shumë mundësi të rinjve të marrin pjesë në vendimmarrje	77.9%	18.4%	3.5%	0.0%	0.2%

Tabela 4. Ndërhyrjet që bashkia/vendimmarrësit duhet të ndërmarrin

Lidhur me aktivitetet ku të rinjtë dëshirojnë të marrin pjesë më shumë, vihet re se shumica e tyre preferojnë aktivitetet sportive, kulturore, vullnetare si dhe aktivitet të pastrimit të lagjes apo dhe takime lidhur me çështjet e të rinjve. Një element i rëndësishëm që vihet re është se shumica e të rinjve nuk preferojnë të marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme partiake. Pra, aktivitetin e tyre e lidhin më shumë me aktivitete të natyrës kulturore, sportive apo vullnetare sesa me aktivitetet politike.

	Po	Jo	Nuk e di	Pa përgjigje
Aktivitet partiak	37.4%	49.0%	11.1%	2.5%
Aktivitet sportive, kulturor	87.4%	8.5%	3.0%	1.1%
Aktivitet të pastrimit të qytetit, lagjes	80.1%	13.2%	6.0%	0.7%
Aktivitete vullnetare	82.9%	11.8%	4.3%	1.0%
Takime diskutuese/vendimmarrëse për çështjet e të rinjve	75.8%	14.9%	8.1%	1.2%

Tabela 5. % e aktiviteteve ku të rinjtë dëshirojnë të marrin pjesë

Siç e shohim nga tabela 6, shumica e të intervistuarve pohojnë se aktivizimi qytetar i të rinjve forcon demokracinë, mundëson që procesi i vendimmarrjes të jetë më përfaqësues duke bërë që zëri i tyre të dëgjohet më shumë, krijon hapësira për të rinjtë që të shfrytëzojnë talentet e tyre duke ndryshuar kështu dhe jetën e të rinjve, si dhe stimulon qasje e ide për zgjidhjen e shumë problemve që prekin komunitetin dhe jo vetëm.

Pra, përqindja e të rinjve të përfshirë në këtë raport që kanë pohuar se aktivizimi qytetar është i lidhur me funksionimin e demokracisë, gjithëpërfshirjen në vendimmarrje dhe zhvillimin e qasjeve të reja për zgjidhjen e shumë problemve është më e lartë se përqindja e të rinjve që e mohojnë atë apo preferojnë të mos përgjigjen.

	Po	Jo	Nuk e di	Pa përgjigje
Forcon funksionimin e demokracisë	75.4%	9.1%	12.3%	3.2%
Krijon hapësirë për të rinjtë që t'i shfrytëzojnë talentet e tyre të fuqishme në dobi të gjithë komunitetit	81.6%	6.7%	8.9%	2.8%
Mundëson që procesi i vendimmarrjes të jetë më përfaqësues	74.2%	9.0%	13.3%	3.5%
Mundëson që zëri i tyre të dëgjohet	82.9%	6.7%	8.7%	1.7%
Ndryshon pozitivisht jetën e të rinjve	80.4%	7.9%	9.4%	2.3%
Stimulon qasje dhe ide të reja për zgjidhjen e problemeve vendore dhe rajonale	74.0%	7.9%	14.6%	3.5%

Tabela 6. Efektet e qytetarisë aktive sipas të rinjve

Referuar të dhënave të nxjerra nga kryerja e intervistave (figura 22), të rinjtë e Elbasanit rreth 69.3% shprehen se **kanë dëgjuar** për qytetarinë aktive, ndërsa 20.3% **nuk kanë dëgjuar** për qytetarinë aktive dhe 10.4% kanë preferuar të mos përgjigjen.




Figura 16. % e informacionit për qytetarinë aktive




Figura 17. Burimi i informacionit për qytetarinë aktive

Një element i rëndësishëm që vihet re nga të dhënat (figura 17) është se për të rinjtë e Elbasanit burimi i informacionit lidhur me qytetarinë aktive është shkolla. Pra informacioni më i madh kalon në ambientet e shkollës lidhur me rëndësinë dhe zhvillimin e qytetarisë aktive. Duke vijuar më pas me rrjetet sociale si burimi i dytë i marrjes së informacionit, ku 14% e të rinjve shprehen se përmes Facebook, Instagram dhe Twitter kanë më shumë informacion për qytetarinë aktive. Burime të tjera informacioni janë edhe televizioni/ radio, miqtë, familja dhe bashkia që kanë ndihmuar të rinjtë të kenë sado pak informacion për qytetarinë aktive dhe të qenurit qytetar aktiv.

Ndërkaq lidhur me arsyet e mos angazhimit të të rinjve në komunitet rezultojnë se:

- 34% e të intervistuarve theksojnë se nuk angazhohen në komunitet për shkak të mungesës së interesit;
- 30.5% e të intervistuarve thekson se nuk angazhohen në komunitet për shkak të mungesës së informacionit;
- 18.5% e të intervistuarve shprehen se mos angazhimi vjen si pasojë e mungesës së mundësive;
- 5.3% e të intervistuarve shprehen se për mungese kohe nuk mund të angazhohen në komunitet.




Figura 18. Arsyet e mungesës së angazhimit tek të rinjtë në komunitet

V. GJETJET KRYESORE

Disa nga gjetjet kryesore të këtij raporti janë si më poshtë:

- 34% e të intervistuarve theksojnë se nuk angazhohen në komunitet për shkaqe të mungesës së interesit dhe 30.5% e të intervistuarve thekson se nuk angazhohen në komunitet për shkak të mungesës së informacionit;
- 80.3% e të rinjve mendojnë që bashkia/vendimmarrësit duhet të mbështesin zhvillimin e këshillave rinor, 78.1% prej tyre mendojnë që bashkia duhet të jetë më transparente në vendimet që merr për të rinjtë dhe komunitetin dhe 80.6% e të rinjve të intervistuar mendojnë që bashkia duhet të dëgjojë mendimin, idetë dhe nevojat e të rinjve përpara marrjes së vendimeve;
- Kur flasim për takimet apo aktivitetet ku duhet të marrë pjesë një qytetar aktiv 43.5% e të rinjve mendojnë që është disi e rëndësishme të marrin pjesë në protestë; 33.8% mendojnë që për një qytetar është disi e rëndësishme të votoj;
- 47.2% e të rinjve shprehen se nuk kanë marrë pjesë ndonjëherë në takimet publike të organizuara nga bashkia ku jetojnë duke treguar mungesë informacioni të aktiviteteve dhe konsultimeve të ndërmarra nga bashkia, gjë e cila konfirmohet nga 51.5% e të anketuarëve që nuk janë aspak të informuar mbi aktivitetet që bashkia ku jetojnë organizon apo planifikon;
- Të rinjtë përgjithsisht kanë njohuri dhe informacione për karakteristikat e një qytetari aktiv dhe në një përqindje të lartë ata shprehen se një qytetar aktiv paguan taksat, angazhohet në punë vullnetare, beson në të drejta të barabarta për të gjithë, mban pastër hapësirat publike, mbron mjedisin, ndihmon fqinjët dhe komunitetin, nuk ka frikë të shprehë publikisht pikëpamjet e veta për të mirën e përgjithshme, respekton minoritetet në komunitet etj., por kur vjen çështja tek pjesëmarrja në demokraci nëpërmjet metodave ligjore apo metoda të tjera të pjesëmarrjes qytetare, 26.2% e të rinjve shprehen që një qytetar aktiv nuk angazhohet në fushata ose peticione, 29.4% shprehen që një qytetar aktiv nuk kontakton përfaqësuesit e vet politik, 14.8% mendojnë që nuk merr pjesë në konsultime për çështje të ndryshme me vendimmarrësit, 22.2% që nuk merr pjesë në zgjedhje/votime dhe 22.1% që nuk voton rregullisht.

VI. REKOMANDIME

Nisur nga rezultatet e intervistave të realizuara me të rinjtë e qarkut Elbasan në shtatë bashkitë si Bashkia Elbasan, Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, Prrenjas dhe Peqin, na paraqesin disa rekomandime që synojnë të ndikojnë në përmirësimin e situatës, duke dhënë orientime për përmirësimin si në drejtim të rritjes së informimit dhe ndërgjegjësimin të të rinjve lidhur me qytetarinë aktive, ashtu dhe rritjes së ndërhyrjes nga autoritetet lokale dhe institucionet arsimore me shërbime mbështetëse ndaj të rinjve që stimulojnë aktivizimin e tyre në komunitet si forcim i demokracisë.

Në këtë kuadër disa nga rekomandimet e konkluduara janë si më poshtë:

1. Njësitë e qeverisjes vendore të hartojnë programe me fokus specifik të rinjtë dhe qytetarinë aktive sipas nevojave të identifikuara dhe duke mbajtur në konsideratë analizat gjinore. Këto programe të adresojnë çështje konkrete ku të veshin të rinjtë me aftësi dhe njohuri për zgjidhjen e problemeve në komunitet dhe të kontribuojnë në rritjen e komunikimit dhe bashkëveprimit mes bashkisë dhe të rinjve. Nga ana tjetër të shoqërohen me linja buxhetore të përcaktuara, krahas planeve të veprimit apo dokumentave të tjerë politik.
2. Të rritet komunikimi nëpërmjet bashkisë dhe qytetarëve nëpërmjet përdorimit të kanaleve zyrtare të komunikimit të bashkive për sa i përket konsultimeve publike, shpalljes të vendimeve dhe aktiviteteve të tjera që kanë në fokus pjesëmarrjen qytetare dhe sigurimin e hapësirave të trajtimit të problemeve të komuniteteve. Ndërhyrje e cila do çonte dhe në implementimin e kompetencave ligjore të ligjit "Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 Për Vetëqeverisjen Vendore".
3. Të implementohen parashikimet ligjore të ligjit "Për Rininë" për sa i përket themelimit të Këshillave Vendor të Rinisë si një instrument që siguron pjesëmarrjen e të rinjve në procese të vendimmarrjes dhe politikëbërjes.
4. Institucionet arsimore duhet të shtojnë aktivitetet dhe përmbajtjen në kurrikula lidhur me qytetarinë aktive, rëndësinë e votimit, protestave, peticioneve, ndërveprimit me përfaqësuesit në nivel lokal e qendror dhe pjesëmarrjes në konsultime publike dhe rolin e tyre në forcimin e demokracisë vendore.
5. Organizatat civile/jo qeveritare që veprojnë në nivel lokal duhet të rrisin bashkëveprimin me njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet arsimore. Gjithashtu duhet të rrisin më shumë ndërveprimin përmes nismave apo projekteve të ndryshme me të rinjtë.
6. Institucionet arsimore duhet të inkurajojnë sa më shumë të rinjtë që të marrin pjesë në punë vullnetare apo organizata të ndryshme me qëllim rritjen e aktivizimit qytetar.

Bibliografia

1. Active Citizenship Kosovo, "Qytetaria Aktive" https://www.syrriivizionit.org/repository/docs/Broshura_Qytetaria_Aktive_SHqip_ëeb.pdf
2. Wilson, John (2000), "Volunteering", *Annual Review of Sociology* (26): 215. doi:10.1146/annurev.soc.26.1.215
3. Investopedia, Julia Kagan, 202. Income Tax Terms Guide, <https://www.investopedia.com/terms/t/taxes.asp>
4. "Example of an organization", <https://www.vocabulary.com/dictionary/organization>
5. Cambridge Dictionary, <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/campaign>
6. "Petition", Collier's New Encyclopedia, 1921
7. Britannica, The Editors of Encyclopaedia, "Minority". *Encyclopedia Britannica*, 18 Sep. 2019, <https://www.britannica.com/topic/minority>. Accessed 16 July 2021.
8. Rinia Shqiptare 2015, Raport, Fondacioni Friedrich Ebert,
9. <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>
10. Balkan Barometer, Regional Cooperation Council: 2017

ANEKSI. MODELI I PYETËSORIT TË PËRDORUR

Informacion i përgjithshëm mbi të anketuarin

1. Gjinia:

- Mashkull
- Femër
- Tjetër

2. Sa vjeç jeni?

3. Cili është niveli më i lartë arsimor që keni përfunduar?

- Nuk jam i/e arsimuar
- Arsimit fillor
- Arsimit mesëm
- Universitar (BA)
- Pas-universitar (MA/MS/Dr. etj).

4. Cili është statusi juaj?

- Gjimnazist
- Student/e
- I/e papunë
- I/e punësuar formal (i siguruar)
- I/e punësuar informal (i pasiguruar)
- I/e vetëpunësuar
- Tjetër _____

Pyetje specifike

5. Cila është bashkia ku ju jetoni:

- Elbasan
- Cërrik
- Belsh
- Prrenjas
- Peqin
- Librazh
- Gramsh

6. A jeni pjesë e ndonjë shoqatë/organizatë joqeveritare/klubi ose forumi rinor?

- Po
- Jo
- Pa përgjigje

Nëse po, zgjidhni një nga alternativat e mëposhtme:

Pjesë e një shoqatë/organizatë joqeveritare/forumi:

- Kulturor
- Sportiv
- Politik
- Edukativ
- Fetar
- Vullnetar
- Tjetër _____
- Pa përgjigje

7. A keni kryer ndonjë punë vullnetare në komunitetin ku jetoni?

- Po
- Jo
- Pa përgjigje

8. Nëse po, sa ndikim mendoni se ka patur puna juaj vullnetare?

- Ndikim të madh
- Ka ndikuar
- Pak
- Aspak

9. Sa gjasa ka të vazhdoni të bëni punë vullnetare në vazhdimësi?

- Shumë
- Disi
- Pak
- Aspak

10. Arsyeja e angazhimit tuaj në komunitet është:

- Për të mirën e komunitetit
- Për arsye personale
- Për arsye politike
- Tjetër _____
- Pa përgjigje

11. Cili është aktiviteti që keni marrë pjesë më shpesh:

- Protestë
- Aktivizim vullnetar në ndihmë për njerëzit në nevojë
- Aktivizim vullnetar për pastrimin e lagjes/qytetit/komunitetit
- Event kulturor, sportiv, fetar
- Takim publik me vendimmarrësit e komunitetit
- Fushatë elektorale
- Aktivitet akademik/edukativ
- Tjetër_____
- Pa përgjigje

12. A mendoni që aktivizimi i të rinjve ndihmon komunitetin dhe mirë funksionimin e politikave:

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Pa përgjigje_____

13. Sa i/e interesuar jeni për aktivizim në komunitetin ku jetoni?

- Shumë i interesuar
- Deri diku i interesuar
- Jo edhe aq i interesuar
- Aspak i interesuar
- Nuk e di

14. A diskutoni me famijarët, miqtë apo të afërmit lidhur me aktivizimin në komunitet?

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Pa përgjigje

15. A keni marrë pjesë ndonjëherë në takimet publike të organizuara nga bashkia ku jetoni?

- Po
- Jo
- Pa përgjigje

16. Sa të informuar jeni mbi aktivitetet e bashkisë ku jetoni?

- Shumë të informuar
- Të informuar
- Pak të informuar
- Aspak të informuar

17. Sipas mendimit tuaj, një qytetar aktiv është ai/ajo që?:	Po	Jo	Nuk e di	Pa përgjigje
Paguan taksat				
Voton rregullisht				
Mban pastër hapësirat publike				
Mbron mjedisin				
Ndihmon fqinjët dhe komunitetin				
Ndihmon këdo që ka nevojë				
Merr pjesë në zgjedhje/votime				
Beson në të drejta të barabarta për të gjithë				
Nuk ka frikë të shprehë publikisht pikëpamjet e veta për të mirën e përgjithshme				
Merr pjesë në ngjarje publike për çështje të rëndësishme publike				
Merr pjesë në konsultime për çështje të ndryshme me vendimmarrësit				
Kontakton përfaqësuesit e vet politikë				
Ndjek zhvillimet politike të vendit				
Ndjek zhvillimet ndërkombëtare në nivel global (politik, ekonomik, shoqëror etj.)				
Angazhohet në fushata ose peticione				
Angazhohet në punë vullnetare				
Respekton minoritetet në komunitet				

18. Sa e rëndësishme është për një qytetar:	Shumë	Disi	Pak	Aspak
Të votojë				
Të marrë pjesë në protestë				
Të marrë pjesë në aktivitete vullnetare				
Të marrë pjesë në takime/konsultime vendimmarrëse për të rinjtë				
Të jetë pjesë e takimeve dhe eventeve publike për komunitetin				
Të ndjek zhvillimet politike të vendit				

19. A jeni dakord që bashkia/ vendimmarrësit ku jetoni duhet:	Shumë Dakord	Dakord	Pjesërisht Dakord	Nuk jam dakord	Aspak Dakord
Tu japë më shumë mundësi të rinjve të marrin pjesë në vendimmarrje					
Të jetë më transparente në vendimet që merr për të rinjtë dhe komunitetin					
Të ftoj të rinjtë në konsultime publike mbi projekte dhe investime të bashkisë					
Të inkurajojë/angazhojë qytetarët dhe të rinjtë të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme					
Të dëgjojë mendimin, idetë dhe nevojat e të rinjve përpara marrjes së vendimit					
Të mbështes zhvillimin e këshillave rinor					

20. A do dëshironit të merrnit pjesë në:	Po	Jo	Nuk e di	Pa përgjigje
Takime diskutuese/vendimmarrëse për çështjet e të rinjve				
Aktivitete vullnetare				
Aktivitet partiak				
Aktivitet të pastrimit të qytetit, lagjes				
Aktivitet sportive, kulturor				

21. Sipas mendimit tuaj, aktivizimi qytetar i të rinjve në komunitet:	Po	Jo	Nuk e di	Pa përgjigje
Mundëson që procesi i vendimmarrjes të jetë më përfaqësues				
Forcon funksionimin e demokracisë				
Stimulon qasje dhe ide të reja për zgjidhjen e problemeve vendore dhe rajonale				
Mundëson që zëri i tyre të dëgjohet				
Krijon hapësirë për të rinjtë që t'i shfrytëzojnë talentet e tyre të fuqishme në dobi të gjithë komunitetit				
Ndryshon pozitivisht jetën e të rinjve				

22. Cili është burimi i informacionit nga ku keni marrë njohuri mbi qytetarinë aktive:

- Shkolla
- Familja
- Miqtë
- Bashkia
- Rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Twitter)
- Gazetë
- Televizion/Radio
- Asnjë
- Tjetër _____

23. Si mendoni, mungesa e angazhimit të rinjtë në komunitet vjen si pasojë e:

- Mungesë informacioni
- Mungesë kohe
- Mungesë mundësisë
- Mungesë interesi
- Tjetër _____
- Pa përgjigje

